




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 12.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.05.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik EL BAU SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrugës " Hamdi Kurteshi " - Gjilan' me Nr. të Prok: 651-23-3604-5-1-1, mori këtë:

VENDIM

Aprovohet pjesërishtë- si e bazuar Kërkesa për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik EL BAU SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrugës " Hamdi Kurteshi " - Gjilan' me Nr. të Prok: 651-23-3604-5-1-1, dhe

Njoftimi për Kontratë e AK-së, të datës 14.04.2023.

Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë korigjimin e dosjes së tenderi, duke e korigjuar në harmoni me LPP dhe po ashtu do të vazhdohet me këtë aktivitet .

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori ekonomik EL BAU SH.P.K.,si palë e pakënaqur me datë 05.05.2023 ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues të Komunës së Gjilanit kundër Njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrugës " Hamdi Kurteshi " - Gjilan' me Nr. të Prok: 651-23-3604-5-1-1 dhe me pretendimin se AK ka vepruar në kundërshtim të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të paraqitur në Kërkesën për Rishqyrtim të parashtruesit, shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit dhe analizës konkrete në mënyrë të drejtë të gjitha fakteve dhe provave të administruara, gjeti dhe konstatoi se Kërkesat për Rishqyrtim të parashtruesve aprovohen si pjesërisht të bazuara.

Tek pretendimi i parë ankimor dhe tek pretendimet tjera, keni shkruar dhe hamendësuar qe dosja e tenderit dhe kushtet e saj janë përgaditur apo përshtatur për ndonjë OE të caktuar. Ne si AK mendimet e juaja dhe pretendimet e juaja nuk mundemi të jua shpalosemi dhe përshtatemi. Ne ju sigurojmë që kërkesat që janë vendosur në FTD janë minimale me vëllimin e punëve që do të ekzekutohen, sidomos me vlerën e projektit dhe me rëndësinë që ka për qytetarin dhe sidomos banorët afër.

Fillimisht dosja dhe tenderi janë publikuar me datë 17.04.2023, dhe ju keni pritur me jave për të bërë ankesë deri me 05.05.2023 (I cili ka qene afati i parë për dorëzim, para shtyrjes së parë), edhe pse qysh ne fillim keni parë kushtet e tenderit. Kjo mendojmë se tregon tendencën e juaj si OE sikur ne rastet dhe aktivitetet tona tjera rreth bllokimit të proceseve dhe zhvillimit të Komunës, sikur që është edhe bllokimi dhe zhvillimi infrastrukturës dhe jetes me te lehte për banoret e qytetit tone. Andaj kjo pike ankimore nuk ka bazë.

Pretendimi ankimor i parë :

Një (1) Inxhinier të diplomuar ose master i diplomuar drejtimi Menaxhimi i Emergjencave i certifikuar në njërën nga qendrat për trajnim për Siguri dhe Shëndet në Punë, të listuara nga Minsitria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të R.Kosovës. Me min. 5 vite përvoj pune profesionale pas diplomimit.

Kërkesa që inxh në fjalë "të jetë i certifikuar në njërën nga qendrat për trajnim për Siguri dhe Shëndet në Punë është kërkesë jo-obligative, e panevojshme dhe si e tillë është hartuar/përshtatur që t'i krijojë favore një OE të njohur në mënyrë t'i lejoj avantazh për ta kufizuar dhe eliminuar konkurrencën në raport me OE tjerë,

Mbrojtja dhe menaxhimi i kushteve të punës për punëtorët duke përfshirë edhe mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit në punë është e rregulluar me ligjet apo rregulloret në Republikën e Kosovës. Nuk mund të përcaktohet me kërkesa të veçanta e të cilat shkelin parimet ligjore si në rastin konkret. Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë që përcakton masat për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë. Andaj çdo kompani/OE ka detyrim ligjor që të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit. Autoritet ligjor që të mbikqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë është Inspektoriati i Punës.

Prandaj, duke qenë se kjo kërkesë "të jetë i certifikuar në njërën nga qendrat për trajnim për Siguri dhe Shëndet në Punë" është jo-relevante, kufizuese dhe në kundërshtim me parimet dhe kërkesat ligjore të barazisë në prokurim, kërkojmë nga AK që të largohet nga dosja e tenderit.

Përgjigje në pretendimin ankimor pika e parë :

Per arsye qe puna do të zhvillohet në një rën prej arterieve kryesore të qytetit të Gjilanit, ne punishte duhet të angazhohet një inxhinier i diplomuar për Menaxhimin e Emergjencave, i cili duhet të angazhohet një menaxhim të çfardo situatë të nevojshme të krijuar gjatë procesit të punës, i cili po ashtu duhet të jetë i certifikuar për Siguri dhe Shendet në punë, pasi qe puna qe do të zhvillohet është mjaft komplekse dhe ka gërmime të medha në infrastrukturë. andaj kërkesa është bazuar sipas pershkrimit të punës qe do të zhvillohet. Ju keni cekur qe mbrojtja dhe menxhimi i kushteve të punës për punëtor duke përfshirë edhe mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit në punë është e rregulluar me ligjet apo rregulloret në Republikën e Kosoves.

Çertifikimin si të tillë edhe ju sic e dini e bene edhe Oda Ekonomike e Kosoves perkatesisht me Ministrin përkatëse të Republikës së Kosoves, dhe trajnimi dhe certifikimi bëhet sipas ligjet dhe rregulloret e punës të Republikës së Kosoves. Gjithashtu këtë trajnim duhet ta bëjnë persona qe kanë një profesion- edukim (diplome) paraprakishtë, është kusht në regjistrim. Ne nuk kemi mundur që të kërkojmë për një inxhinier ndërtimtaris që të jetë i certifikuar me siguri dhe shendet në punë (pasi inxhinier ndërtimtaris duhet të jetë i angazhuar në ndërtimin e infrastrukturës, shtratit të lumit dhe rrugës) por ne kemi kërkuar konkretisht person qe është i thirrur për këtë punë dhe atë në lëminë e Menaxhimit të Emergjencave dhe qe lidhet direkt me Sigurin dhe Shendetin në Punë. Që do të thotë, ne rastet kur do të ndodhë ndonjë fatkeqësi, menaxhimin e atij rasti më së miri mund ta bëjë një person qe është inxhinier në lëminë e menaxhimit të emergjencave, pasi se paku ai apo ajo e ka kryer një shkollim për një punë të tillë dhe një certifikim për një punë të tillë.

Duke e ditur kompleksitetin e punës, lokacionin urban që do të zhvillohen punimet, kërkesa e tillë është e minime dhe e pamangshme, në kuptimin qe duhet të minohen deri në maksimum shkaktoarët e mundshëm të ndonjë fatkeqësie në punishte dhe këto e bene me se miri personeli i certifikuar për këto punë. Andaj pretendimi ankimor kësaj pike nuk mirret parasysh.

Pretendimi ankimor i dytë :

Një (1) Inxhinier të diplomuar ose master I diplomuar drejtimi Infrastrukturë Rrugore Me min 5 vitë përvojë punë në angazhime profesionale pas diplomimit.

Në bazë të dhënave publike në Universitetet Publike dhe Private që veprojnë dhe janë të akredituara në Republikën e Kosovës, drejtimi Infrastrukturë Rrugore nuk egziston si program studimi as në nivelin bachelor e as nivelin master.

Në rastet si ky, ku AK vendos kërkesa të veçanta që e kanë karakterin dhe qëllimin favorizues në dobi të njëjës palë dhe diskriminues për palët tjera, dhe të cilat nuk janë të pranishme, respektivisht nuk mund të sigurohen në Republikën e Kosovës, AK duhet ta argumentoj me fakte konkrete se pse na çenka kaq relevante kjo kërkesë e veçantë, nga cili projekt është referuar, dhe të tregoj se ku mund ta sigurojmë OE tjerë.

Në këtë mënyrë, rezulton se kjo kërkesë e paarritshme sistemin e arsimit të lartë në

Republikën e Kosovës, është kërkesë që është përshtatur sipas nevojave të një OE të caktuar (identifikueshëm) me qëllim t'i krijojë favore për t'a kufizuar, eliminuar konkurrencën në dëm të operatorëve tjerë ekonomik.

Përgjigje në pretendimin ankimor pika e dytë :

Në këte pikë ankimore keni shkruar që sipas të dhënave publike profesioni si i tillë "drejtimi infrastrukturë rrugore" nuk egziston. Ne shprehimisht dhe me qellim të informimit edhe për ju si kompani ju njoftojmë se si program egziston dhe atë në Universitet Publik të Kosovës. Andaj shkrimi i juaj që "nuk egziston" është keq informim dhe dezinformim për OE të tjera.

Pasi që ju si OE keni shume kontrata me ne si AK, dhe konkretisht në lejmin e ndërtimit të rrugëve dhe infrastrukturës, për ne si AK është për çudi kërkesa juaj që kjo pike nuk është relevante. Ne ju njoftojmë që kjo kërkesë nuk është aspak e vecantë, kundërshtuar është shume bazike, pasi shume thjeshte kemi të bëjmë me ndërtim të infrastrukturës rrugore. Inxhinieri i infrastrukturës madhore në gjitha kërkesat publike dhe detyrat e thirrura, është përgjegjës për rastet e hartimit të projekteve rrugore apo menaxhimin e projekteve rrugore në ndërtim.

Inxhinieri i infrastrukturës rrugore, është caktuar një kriter duke u bazuar për llojin e punës, ku në projekt është paraparë pikërisht ndërtim i infrastrukturës rrugore, është kaq e thjeshte dhe e evidente. Për më tepër ne mund të ju deshmojmë shume konkurse publike dhe private mbi këtë kërkesë sikur të punësimet në institucione por edhe të konkurseve të projekteve. Andaj pretendimi ankimorë i pikes tre bie.

Pretendimi ankimor të tretë :

Një (1) Inxhinier të diplomuar ose master i diplomuar i Hidroteknikës. Me min, 1 Vite përvojë punë angazhime profesionale pas diplomimit. I certifikuar për hartimin e elaboreve mbrojtje nga zjarri

Kërkesa që inxh në fjalë "të jetë i certifikuar për hartimin e elaboreve nga zjarri" kërkesë nuk është relevante dhe nuk ka asnjë peshë të caktuar lidhur me objektin e kontratës. Kjo kërkesë është e hartuar/përshtatur për t'i krijuar favore një OE të njohur në mënyrë që të njejtit t'i lejoj avantazh për ta eliminuar konkurrencën në raport me OE tjerë. Sepse nuk është aspak e nevojshme, relevante dhe e lidhur me objektin e kontratës, dhe si e tillë në pikpamje faktike dhe ligjore, bie ndesh me parimet dhe kërkesat ligjore të barazisë/jo-diskriminimit dhe përcaktimit të kriterëve të përzgjedhjes, respektivisht kërkesave minimale për kualifikim.

Prandaj, duke qenë se kjo kërkesë "të jetë i certifikuar për hartimin e elaboreve nga zjarri" është jo-relevante, kufizuese dhe në kundërshtim me parimet dhe kërkesat ligjore të barazisë në prokurim, kërkojmë nga AK që të largohet nga dosja e tenderit.

Përgjigje në pretendimin ankimor të tretë :

Inxhinieri i Hidroteknikës i certifikuar për hartimin e elaboreve për mbrojtje nga zjarri, duhet të angazhohet në projekt dhe gjatë fazave do të kërkohen elabore dhe raport përcjellës për mbrojtje nga zjarri, pasi pjesa ku do të ndërtohet dhe gërmohet ka shume instalime, si nëntokësore dhe mbitokësore, andaj menaxhimi i punëve në terren kërkohet strikt, në mënyrë që mos të vij deri tek ndonjë fatkeqësi. Gjithashtu duke u nisur që do të punohet edhe nga pjesa e brendshme e FSK-së ku ka instalime nëntokësore, si dhe pjesa kryesore e rruges Hamdi Kurteshi ka instalime të tjera egzistuese Elektrike, Ujësjellës dhe Kanalizime është kërkuar që inxh. i hidroteknikës të jetë i certifikuar edhe për hartimin e elaboreve për mbrojtjen nga zjarri, ku para fillimit të punës dhe gjatë procesit të punës në çdo etap të punës, do të kërkohet nga AK dhe zyrtarët përgjegjës të mbikëqyrë raporte prej secilit inxhinier të thirrur, e në këte

rast edhe prej inxh. të hidroteknikes do të kerkohen raporte dhe elabore mbi procesin e punës deri në mos ardhjen e ndonjë fatkeqesie në punishte duke e ditur që zona është urbane dhe shume e ngarkuar, sikur që është kërkuar plan për menaxhimin e komunikacionit. Në projekt është parapararë ndërtimi i infrastruktures elektrike nentokesore dhe mbitokesore ku sipas pershkrimit të projektit kap vlerën rreth 20% të projektit, andaj inxhinieri i tillë dhe kërkesa e tillë për mbrojtje nga zjarri është kërkesë që pershatet dhe e nevojshme me procesin e punës. Andaj pretendimi ankimor i pikes katër bie.

Pretendimi ankimor të katërt :

Inxhinier i diplomuar ose mastër i Gjeodezis i Licencuar. Me min 5 Vite përvojë pune-angazhime profesionale pas diplomimit

Kërkesa për "Inxhinier i diplomuar ose mastër i Gjeodezis i Licencuar nuk është drejtpërdrejtë relevante dhe e nevojshme për objektin e kontratës dhe si e tillë konsiderojmë se është ngatërruar nga ana e AK-së për arsye se në projektin konkret licenca do të duhej të ishte për matje kadastrale dhe jo gjeodezike.

Prandaj/ duke qenë se edhe kjo kërkesë bie ndesh me kërkesat relevante e të nevojshme për objektin e kontratës dhe me parimet/kërkesat ligjore të barazisë dhe kriterëve të përzgjedhjes, kërkojmë nga AK që kjo kërkesë të largohet në mënyrë që të korrigohet dhe zavendësohet me kërkesën Inxhinier i diplomuar ose mastër-Bachelor i Gjeodezis

Përgjigje në pretendimin ankimor të katërt :

Kërkesa për Inxhinier i diplomuar apo master i Gjeodezis, është valide dhe e thirrur për natyrën e punës, dhe si e tillë qendron, pasi që edhe tek inxhinieret është kërkuar inxhinier apo master (dhe jo bachelor) duke e ditur kompleksitetin e punës dhe vëllimin e punës, ku kerkohet staf me me përvojë për punë të tilla. Janë lënë dy mundësi si Inxhinier i diplomuar apo master. Dhe më heret në aktivitet tona tjera kemi kërkuar kërkesa të tilla, dhe atë pikërisht edhe për inxhinierin e gjeodezise.

Sa i përket Licences, ne nuk kemi kërkuar që të jetë i Licencuar për Gjeodezi, kërkesa ka qenë dhe është inxh. i diplomuar ose master i Gjeodezise, i Licencuar, dhe siç dihet licenca lëshohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe licencat e tilla janë standarde në Republikën e Kosovës.

Diploma universitare dhe licenca janë dy gjëra të ndryshme, dhe siç dihet një Gjeodet duhet të jetë i Licencuar, andaj ne kemi kërkuar edhe licencën valide. Ajo kerkohet që të jete valide. Andaj pretendimi ankimor i pikes pese bie.

Gjithashtu në përputhje me nenin 13.2 të LPP-se, AK mund të përcaktoj kushtet dhe termet e kontratave publike të cilat duhet të jenë në përputhje me praktikën e zakonshme publike dhe afariste për llojin dhe lëndën e veçantë të kontratës përkatëse. Është kërkesa për Menaxhim të Emergjencave dhe siguri në punë, apo inxh. i infrastrukturës rrugore, pasi janë të dizajnuara për punë komplekse, dhe puna që do të kryhet është mjaftë komplekse dhe për shkak të kompleksitetit të punimeve kërkohet më shume fleksibilitet në mënyrë që të zbatohet projekti si duhet.

I nderuar OE ankues,

*Në ankesën tuaj keni shkruar mbi tenderat publik dhe zyrtarët tanë përgjegjës.
Ne ju njoftojmë dhe ju garantojmë që kërkesat janë shume minore me kompleksitetin e kontratës.
Ne si AK, nuk mund dhe nuk dëshirojmë që të drejten e çdo OE të ja mohojmë për çfarëdo
ankese dhe pretendimi, edhe ju si ankues mund ta dini meqenëse jeni kontraktuesi me i madh ne
zyren tone.*

*Ne vetem mund te ju garantojmë që asnjë kriter dhe asnjë kërkesë nuk është e pabazuar dhe e
panevojshme, siç e cekëm edhe më lartë kërkesat janë mjaftë minore duke pasur
parasysh vëllimin e punës dhe projektit si të tillë.*

*Rreth pretendimit ankimor për shtyrje të afatit ne kemi pasur mirëkuptim dhe menjëherë pas
pranimit të ankesës suaj e kemi shtyer afatin per doërzim, edhe pse konsiderojmë qe ka pasur
kohë*

Shqipe Hoxha



Menaxhere e zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.